

# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7823  
E hënë, 1 korrik 2024  
Çmimi 0.50

Sërish zjarr në  
ndërtesën e Institutit  
të Mjekësisë Ligjore



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)  
 [facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)



POSTERË ME FOTOGRAFINË E VUÇIQIT NË VERI,  
POLICIA HAP RAST PËR NXITJE TË URREJTJES

## PARALAJMËRON SVEÇLA: NËSE VUÇIQI HYN NË KOSOVË PA KËRKUAR LEJE, DO TË ARRESTOHET

I FAQE 4



Posterë me fotografinë e presidentit serb Aleksandër Vuçiq janë vendosur të dielën në katër komunat në veri të Kosovës. Përveç fotografisë së

Vuçiqit, në to shkruhet edhe mesazhi "Komandant Suprem, po të presim". E lidhur me këtë ngjarje ka reaguar edhe ministri i Punëve të Brendshme

të Kosovës, Xhelal Sveçla, i cili ka thënë se nëse presidenti serb futet në Kosovë pa marrë leje nga institucionet e vendit, do të burgoset

SERWERI:  
NEVOJITET  
RIFORMATIMI  
I DIALOGUT,  
LAJÇAKU KA  
DËSHTUAR



NË  
MIRËSEARDHJE  
E REHATSHME  
PËR NËNAT  
DHE FOSHNJAT  
NË QKUK



**RENOVA**  
PUTZ

Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mot: +377 44 501289  
E-mail: renova@m.t.net.mk

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.

NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVË  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË



**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
[info@kolegjibiznesi.com](mailto:info@kolegjibiznesi.com)  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122

Internet Website,  
Marketing...

## OPINION

KOSOVA ME SHUMË<sup>F. 6</sup>  
"POLITIKANË" E PA ASNJË<sup>F. 6</sup>  
BURRËSHTETAS AKTUAL

Shkruan: Safet  
GËRXHALIU



## AKTUALE



ORBANI NJOFTON PËR KRIJIMIN E  
ALEANCËS "PATRIOTËT PËR  
EVROPËN" <sup>F. 2</sup>

O'BRIEN: NA ËSHTË PREMTUAR QË  
RADOIÇIQI DO TË PËRBALLET ME  
LIGJIN NË SERBI <sup>F. 5</sup>

## EKONOMI



INSPEKTI I USHOIMIT, MBI 400 MIJË  
KILOGRAMË PRODUKTE U ASGJËSUAN  
NGA AUV-I GJATË KËTIJ VITI <sup>F. 8</sup>

## SPORT



EKIPET ME MË SË SHUMTI TIFOZË  
NË 'EURO 2024', SHQIPËRIA LË  
PAS KOMBËTARE TË MËDHA <sup>F. 10</sup>

## Orbani njofton për krijimin e aleancës “Patriotët për Evropën”

BUDAPEST, 30 QERSHOR - Kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, njoftoi se dëshiron të formojë një aleancë të re në Parlamentin Evropian së bashku me partinë e ekstremit të djathtë nga Austria dhe me grupin centrist çek të ish-kryeministrit Andrej Babis. “Ne kemi marrë përgjegjësinë për lansimin e kësaj platforme të re, këtij fraksioni të ri. Dua ta bëj të qartë se ky është qëllimi ynë”, tha kryeministri nationalist hungarez në një konferencë të përbashkët me udhëheqësin e partisë austriake, Partia e Lirisë (FPOe), Herbert Kickl dhe Babis nga partia ANO.

Aleanca e re, e prezantuar me emrin “Patriotët për Evropën”, do të duhet të marrë mbështetjen e partive nga katër shtete të tjera

në mënyrë që të mund të regjistrohet si grup në Parlamentin Evropian. “Një epokë e re po nis dhe pikë së pari ndoshta moment përcaktues për këtë epokë të re është krijimi i një fraksioni të ri politik evropian që do t'i ndryshojë politikat evropiane”, tha Orban. Tre liderët nënshkruan “manifestin patriotik”, duke premtuar “paqe, siguri dhe zhvillim” në vend të “luftës, migrimit dhe stagnimit” që, sipas Orbanit, ka sjellë “elita e Brukselit”. Hungaria të hënën merr kryesimin gjashtëmujor të presidencës të BE-së. Gjatë udhëheqjes së presidencës, Hungaria është zotuar se do të shtyjë përpara “politika të forta evropiane”, me moton “Bëjeni

Evropën të madhe sërisht”, një moto e ngjashme e përdorur nga ish-presidenti amerikan Donald Trump, një mik i mirë i Orbanit. Partia Fidesz e Orbanit ishte pjesë e Partisë Popullore Evropiane - grupit më të madh parlamentar të BE-së - deri në vitin 2021, kur u tërroq nga ky grup, pas akuzave të bllokut evropian për përkqësimin e demokracisë në Hungari. Partia FPOe e Kickl është pjesë e grupit Identiteti dhe Demokracia, ku bëjnë pjesë edhe Tubimi Kombëtar i Marine Le Pen dhe Liga nga Italia. Lëvizja centriste ANO e ish-kryeministrat dhe euroskeptikut Babis njoftoi javën e kaluar se do të largohej nga grapi Renew. FPOe ka gjashtë eurodeputetë, ANO shtatë dhe Fidesz 11.



## Shtatë të vdekur nga stuhitë në Francë dhe Zvicër



PARIS, 30 QERSHOR - Stuhitë e fuqishme dhe shirat e rrëmbyeshëm që goditën Francën dhe Zvicrën gjatë kësaj fundjave kanë lënë të vdekur të paktën shtatë persona, thanë autoritetet më 30 qershor. Tre persona, në të 70-tat dhe 80-tat, vdiqën në rajonin verilindor Aube në Francë të shtunën, kur një pemë u rrëzua mbi makinën me të cilën ata po udhëtonin, teksha shteti është goditur nga erëra të fuqishme. Pasagjeri i katërt është në gjendje kritike,

thanë autoritetet lokale për agjencinë e lajmeve, AFP. Në Zvicër dy persona vdiqën pas shirave të rrëmbyeshëm që shkaktuan rrëshqitje të dheut në juglindje të shtetit, në kantonin italianofolës të Ticinos, tha policia. Më pas autoritetet njoftuan se zbuluan edhe trupat e pajetë të dy personave. Sipas medieve lokale, dy nga viktimat ishin gra që ishin për pushime në Zvicër. Moti i lig, po ashtu, ka lënë disa zona pa energji elektrike në

Zvicër. Edhe javën e kaluar Zvicra u përball me shira të rrëmbyeshëm që lanë të vdekur një person dhe shkaktuan dëme të mëdha. Në veri të Italisë, në Luginën Aosta, u raportua përvrëshime të mëdha për shkak të lumenjve që dolën nga shtrati. Shkencëtarët thonë se ndryshimet klimatike, të nxitura nga aktivitetet e njerëzve, po rrisin ashpërsinë dhe kohëzgjatjen e motit ekstrem, sikurse përmbytjet dhe stuhitë.

## Pheniani: Stërvitjet mes Uashingtonit, Seulit dhe Tokios janë versioni aziatik i NATO-s

PHENIANI, 30 QERSHOR - Koreja e Veriut ka dënuar stërvitjet e përbashkëta ushtarake të Koresë së Jugut, Japonisë dhe Shteteve të Bashkuara, duke i cilësuar si “version aziatik të NATO-s” dhe duke paralajmëruar për “pasoja fatale”.

Ky reagim i Phenianit vjen një ditë pasi këto shtete aleate përfunduan stërvitjet treditore të quajtura “Shqiponja e Lirë”, ku u përfshin raketa balistike dhe mbrojtja ajrore, trajnimet për sulme nga nëndetëset dhe stërvitje për mbrojtje kibernetike.

Udhëheqësit e ShBA-së, Koresë së Jugut dhe Japonisë gjatë një samiti vitin e kaluar u pajtuan që të mbajnë stërvitje vjetore si shenjë e unitetit kundër kërcënimve bërthamore të Koresë së Veriut dhe rritjes së ndikimit të Kinës në rajon. “Ne



dënojmë fuqishëm... shfaqjen provokuese të muskujve ushtarakë kundër Koresë së Veriut”, tha Ministria e Jashtme e Koresë së Veriut, sipas njoftimit të publikuar nga agjencia shtetërore e lajmeve, KCNA. “Raportet mes ShBA-së,

Japonisë dhe Koresë së Jugut duken si versioni aziatik i NATO-s”, tha kjo ministri, duke paralajmëruar për “pasoja fatale”. “Koreja e Veriut kurrë nuk anashkalon lëvizjet e ShBA-së dhe ndjekësve të saj për ta forcuar bllokun ushtarak.”

Në stërvitjet e fundit u përfshih edhe aeroplana mbajtësja amerikane, me fuqi bërthamore, USS Theodore Roosevelt, sistemi raketor japonez JS Atago dhe avionët luftarakë të Seulit të llojit KF-16. Pheniani gjithmonë reagon për

stërvitje të tilla ushtarake, të cilat i cilëson si përgatitje për pushtim. Seuli ka hedhur poshtë akuzat e Phenianit, duke thënë se stërvitjet e fundit ishin vazhdimi i stërvitjeve mbrojtëse që mbahen rregullisht për vite të tëra nga tre aleatët. “Është absurde që Koreja e Veriut, burimi kryesor i tensioneve në Gadishullin Korean, kritikon stërvitjen ‘Shqiponja e Lirë’, duke e cilësuar si ‘NATO aziatike’”, tha Ministria e Mbrotjës e Seulit. Tensionet mes dy Koreve janë rritur së fundi, pasi të dyja kanë hedhur në territorët e njëratjetës balona gjatë javëve të fundit. Veriu i ka mbushur balonat me mbeturina, ndërkëq Seuli ka hedhur balona të mbushura me mesazhe pro-Seulit.

## Gërvalla takon homologun kroat: Duhet të finalizohet anëtarësimi i Kosovës në KiE

**PRISHTINË, 30 QERSHOR** - Fuqizimi i bashkëpunimit në proceset e integrimit euroatlantik të Kosovës, iniciativat e përbashkëta rajonale, bashkëpunimi në siguri, mbrojtje dhe shkëmbime tregtare, ishin temat në fokus të takimit që zëvendëskryeministrja dhe ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika

Gërvalla, pati me ministrin e Jashtëm të Kroacisë, Gordan Grlic-Radman. Në takimin bilateral të mbajtur në Forumin e Dubrovnikut, ministrija Gërvalla shprehu mirënjojen ndaj Kroacisë përmështetjen e madhe që i ka dhënë Republikës së Kosovës në procesin e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, duke dekluaruar se ky proces

duhet të finalizohet sa më shpejt me anëtarësimin e plotë në KiE. Ministrija Gërvalla në takim me ministrin Radman foli edhe rrëth veprimeve destabilizuese të Serbisë në rajon dhe nevojën e rritjes së bashkëpunimit në mes të shteteve properëndimore të Ballkanit Perëndimor përmështetjen e paqes dhe stabilitetit.



## Serweri: Nevojitet riformatimi i dialogut, Lajçaku ka dështuar

**PRISHTINË, 30 QERSHOR** - Profesori në Universitetin "Johns Hopkins" në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Daniel Serwer, thotë se është i nevojshëm riformatimi i dialogut Kosovë - Serbi. Sipas tij, emisari i BE-së përmështetjet e Ballkanit Perëndimor, Miroslav Lajçak, ka dështuar pasi palët s'po e zbatojnë Marrëveshjen Bazë të Brukselit dhe Aneksin e Ohrit dhe, si tilla, janë joefektive.

Ai në një intervistë për KosovaPress ka kritikuar në veçanti Serbinë që s'po pranon ta nënshkruajë marrëveshjen dhe po e mohon vazhdimisht të njëjtën. Analisti amerikan kërkon nga Bashkimi Evropian largimin e masave ndëshkuese ndaj Kosovës, derisa thekson nevojën që sa më shpejt përgjegjësit e sulmit terrorist të vitit të kaluar në Banjskë të Zveçanit të vihen para



drejtësisë. Krahas këtyre, ai deklaron se raportet Kosovë - ShBA janë në një kohë të vështirë, mirëpo shton se s'ka ndryshuar

asgjë sa iu përket qëllimeve përmështetjet e Ballkanit Perëndimor

politike në Ballkanin Perëndimor thotë përmështetjet e Ballkanit Perëndimor më shumë se çdo diplomatë që ka shërbyer në rajon, sipas tij, i njëjtë ka dështuar në dialog.

përafrimeve në çështje praktike në terren sesa drejt normalizimit politik. "Lu takon Kosovës dhe Serbisë ta bëjnë këtë (zbatimin e marrëveshjes). Serbia ka refuzuar qartë me shkrim zbatimin e marrëveshjes së Brukselit. Nuk mund të bëj asgjë përmështetjet e Ballkanit Perëndimor përmështetjet e Ballkanit Perëndimor më shumë larg", thotë ai.

Megjithëse deklaron se emisari i BE-së përmështetjet e Ballkanit Perëndimor, Miroslav Lajçak, e njeh Ballkanin Perëndimor më shumë se çdo diplomatë që ka shërbyer në rajon, sipas tij, i njëjtë ka dështuar në dialog.

## Kurti: e-Kosova, dëshmi e vizionit të qeverisë përmështetjet e t'i kthyer situatat e vështira në ndryshime pozitive



**PRISHTINË, 30 QERSHOR** - Kryeministri Albin Kurti e ka vlerësuar të dobishme platformën e-Kosova e cila është prezantuar gjatë kohës së pandemisë Covid-19.

Në "X", Kurti thotë se platforma e-Kosova tani ofron mbi 175 shërbime online. "I prezantuar vetëm tre vjet më parë gjatë pandemisë Covid-19 përmështetjet e Ballkanit Perëndimor përmështetjet e Ballkanit Perëndimor më shumë se çdo diplomatë që ka shërbyer në rajon, sipas tij, i njëjtë ka dështuar në dialog.

familjare dhe mund të përdorin platformën përmështetjet e Ballkanit Perëndimor më shumë se çdo diplomatë që ka shërbyer në rajon, sipas tij, i njëjtë ka dështuar në dialog.

Më tutje, Kurti ka pohuar se kjo platformë është dëshmi e vizionit të qeverisë përmështetjet e t'i kthyer situatat e vështira në ndryshime pozitive. "e-Kosova është shembulli më i mirë i faktit se ka mundësi edhe në situata të vështira dhe është dëshmi e vizionit të Qeverisë sonë përmështetjet e t'i kthyer situatat e vështira në ndryshime pozitive", ka thënë ai.

## Rashiqi: Lista Serbe e ka humbur ndikimin në veri

**PRISHTINË, 30 QERSHOR** - Ka kaluar më shumë se një vit që kur katër komunitete të Kosovës, Kryetarët përmështetjet e Ballkanit Perëndimor, i Listës Serbe në atë pjesë ka rënë dukshëm.

Ministri përmështetjet e Ballkanit Perëndimor, Nenad Rashiq, thotë se Lista Serbe ka kërcënuar

qytetarët përmështetjet e Ballkanit Perëndimor, i Listës Serbe në atë pjesë ka rënë dukshëm.

shqiptarë. Unë sot e kam dërguar një propozim përmështetjet e Ballkanit Perëndimor, i Listës Serbe në atë pjesë ka rënë dukshëm.





POSTERË ME FOTOGRAFINË EVUÇIQIT NË VERI, POLICIA HAP RAST PËR NXITJE TË URREJTJES

# Paralajmëron Sveçla: Nëse Vuçiqi hyn në Kosovë pa kërkuar leje, do të arrestohet

Posterë me fotografinë e presidentit serb Aleksandër Vuçiq janë vendosur të dielën në katër komunat në veri të Kosovës. Përveç fotografisë së Vuçiqit, në to shkruhet edhe mesazhi "Komandant suprem, po të presim". E lidhur me këtë ngjarje ka reaguar edhe ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, i cili ka thënë se nëse presidenti serb futet në Kosovë, pa marrë leje nga institucionet e vendit, do të burgoset

e mirë.

Ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla, reagoi lidhur me vendosjen e posterëve në veriu të Kosovës, dedikuar president Vuçiq. Ai tha se nëse lideri serb futet në Kosovë, pa marrë leje nga

institucionet e vendit, do të burgoset. "I paskan ngjitur timëz gjatë natës disa posterë në veri të Kosovës. Aty thonë që po e presin presidentin e Serbisë të vijë duke e quajtur atë 'komandant'. Nëse është nisur pa kërkues të Ministria jonë e

Punëve të Jashtme dhe Diasporës, edhe ne po e presim të vijë dhe mandej mund ta vizitonë burg, ku ai i ka tashmë disa miq", ka shkruar Sveçla në "Facebook".

Shfaqja e këtyre posterëve në veri ndodh në kohën kur tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë vazhdojnë të janë të larta që nga maji i vitit të kaluar, kur kryetarët e rinx shqiptarë në katër komunat në veri nisen mandatin.

Tensionet u rritën edhe më shumë në shtator, kur një grup i serbëve të armatosur sulmoi Policinë e Kosovës në Banjskë të Zveçanit, duke vrarë një rreshter.

Përgjegjësinë për sulmin e mori Millan Radoiqiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve në Kosovë që gjëzon mbështetjen e Beogradit.

Prishtina ka kërkuar nga Beogradit t'i dorëzojë Radoiqiqin dhe grupin e tij autoriteteve gjyqësore të Kosovës. Këtë kërkesë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e bëri edhe gjatë raundit të fundit të dialogut që ndërmjetësohen nga Bashkimi Evropian - më 26 qershor. BE-ja tha se kjo ishte një prej tri kushteve që Kosova ka vendosur përrangazhimin e saj në procesin e normalizimit të raporteve me Serbinë.

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 30 QERSHOR** - Në veri të Kosovës janë shfaqur posterë me fotografinë e presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, shoqëruar me mesazhin "Komandant suprem, po të presim".

Posterët e tillë janë hasur në Mitrovicë të Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok - katër komunat në veri të Kosovës të banuara me shumicë serbe.

Zëvendësdrjetori i Policisë së Kosovës për rajonin e Veriut, Veton Elshani, konfirmoi për Radion Evropa e Lirë se autoritetet kanë hapur rast për "nxitje të urrejtjes". "Në disa lokacione në katër komunat në veri të vendit janë shpërndarë pamflete me fotografinë e kryetarit të Serbisë. Pas konsultimit me prokurorin e shtetit është hapur rasti për nxitje të urrejtjes", tha Elshani.

Aktualisht, sipas Elshanit, nuk ka persona të dyshuar për vendosjen e këtyre posterëve, por "policia po punon për ndricim të rastit".

Ndërkëq sa i përket situatës së sigurisë në veri, Elshani tha se është



# Një mirëseardhje e rehatshme për nënët dhe foshnjat në QKUK

**PRISHTINË, 30 QERSHOR** - Në katër reparte të Klinikës së Obstetrikës dhe Gjinikologjisë (KOGJ) në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës u bënë renovime të konsiderueshme, që i përmirësuan kushtet për pacientët dhe për të porsalindurit. Shërbimet sanitare, kontrollimi i klimës, sistemi i thirrjes së infermierëve janë vetëm disa prej përmirësimeve.

Mirjeta, që ka sjellë në jetë fëmijën e dytë, thotë se ka vënë re shumë ndryshime nga përvaja e saj e para dy vjetëve kur ka lindur fëmijën e

parë. "Temperatura në dhomë është konstante. Ka kondicioner dhe dritaret kanë perde. Kur kam qenë atëherë dhoma ka qenë shumë e papastër, ashtu edhe korridoret e tualetet", rrëfen ajo. Mbi shtratin e Mirjetës ishte edhe një pajisje që ajo nuk e kishte vënë re më herët - për sinjalizimin e infermierëve në rast nevoje. "Ta them të drejtën, nuk e kam ditur se për çfarë shërbën", thotë Mirjeta për Radion Evropa e Lirë. "Por edhe nuk kam pasur nevojë, sepse infermierët më kanë vizituar pa i thirrur", tregon ajo.


Me renovimet e bëra është lehtësuar edhe puna e stafit - "për 60 për qind", thotë mamia Hasime Kostanica. "Që nga përfundimi i renovimeve [më 18 qershori] unë kam bërë kujdestari tri herë dhe e kam vërejtur se puna është më e lehtë", thotë Kostanica. "Ka pasur raste kur pacientet i kanë humbur ndjenjat derisa i kemi përcjellë në tualete, pasi ato kanë qenë larg nga dhomat. Tash tualetet janë në dhoma", tregon mama, e cila punon në KOGJ tash e 22 vjet. Ankesat ajo i ka për, siç thotë, stafin e pamjaftueshëm. Thotë se

ka ditë kur për 30 lehona kujdesen vetëm dy infermieri apo mami. Drejtori i Klinikës së Obstetrikës dhe Gjinikologjisë, Zef Ndrejaj, i cilëson renovimet e bëra si "standarde normale dhe të nevojshme" si për pacientet, po ashtu edhe për stafin. "Janë përmirësuar dukshëm kushtet e qëndrimit në klinikë e në dhoma. Nuk do të ketë më dhoma me gjashë shtretë. Tash dhomat janë vetëm me nga dy shtretë", thotë Ndrejaj, duke përmendur vetëm një nga investimet e bëra. Renovimet në katër repartet e

KOGJ-it janë bërë me buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë, kanë kushtuar rrëth 2.5 milionë euro dhe kanë zgjatur rrëth pesë muaj. Zotimet janë se renovime do të bëhen edhe në shtatë repartet e tjera të KOGJ-it.

Sipas drejtorit Ndrejaj, ato që janë bërë tashmë do të mundësojnë edhe disa shërbime të tjera në KOGJ, përfshirë atë për zbulimin e anomalive kromozomike, të defekteve gjenetike e të tjera.

Në KOGJ, brenda 24 orësh, lindin rrëth 30 foshnja. Gjatë gjithë vittit të kaluar kanë lindur rrëth 8 mijë.



## O'Brien: Na është premtuar që Radoiqiqi do të përballet me ligjin në Serbi



**PRISHTINË, 30 QERSHOR** - Ndihmësekretari amerikan i Shtetit, James O'Brien, tha se Serbia ka premtuar se Millan Radoiqiqi do të përballet me ligjin lidhur me ngjarjet e shtatorit në Banjskë të Zveçanit. Radoiqiqi ka marrë përgjegjësinë për sulmin e armatosur nga një grup serbesh ndaj Policisë së Kosovës, që vranë një zyrtar

policor. Gjatë këmbimit të zjarrit më 24 shtator 2023, u vranë edhe tre sulmues serbë.

Zyrtari amerikan gjatë forumit të Dubrovnikut tha se pret që Serbia ta mbajë premtimin. "ShBA-ja dhe BE-ja në mënyrë të vazhdueshme kanë thënë se krimet e kryera në shtator [në Banjskë] duhet të ndëshkohen. Ne presim dhe besoj se na është

premtuar se zoti Radoiqiq do të kalojë nëpër një proces të plotë ligjor në Serbi. Është gjë e mirë që duket se nuk është aktiv në veri të Kosovës, siç ka qenë më herët, shohim se nga kjo ka përfitime pozitive. Ndaj tij është ngritur akuzë dhe presim që procesi ndaj tij të përfundoj", tha O'Brien.

Serbia e akuzon Radoiqiqin për

blerje të armëve, munitioneve dhe mjeteve shpërthyese me fuqi të madhe shkatërruese nga Tuzlla në Bosnjë-Hercegovinë, nga janari 2023 deri më 24 shtator. Atij autoritetet ia kanë ndaluar shkuarjen në Kosovë. Autoritetet në Kosovë e vlerësojnë si akt agresioni sulmin në Banjskë dhe kanë fajësuar Serbinë se ka gisht në të.

Beogradit e ka mohuar përfshirjen.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka vendosur si një prej kushteve për angazhim në dialog me Serbinë, edhe dorëzimin e Radoiqiqit dhe grüp të tij tek autoritetet gjyqësore të Kosovës. Bashkimi Evropian ka thënë se Serbia nuk është treguar e gatshme të pranojë këtë kusht gjatë raundit të fundit të dialogut të mbajtur më 26 qershor.

Duke folur për Kosovën dhe Bosnjë-Hercegovinën, O'Brien tha se në dy shtetet duhet të përjashtohet mundësia e përdorimit të forcës përzgjidhjen e çështjeve. "Mendoj se duhet të jemi të qartë se përdorimi i forcës përzgjidhja duhet të përjashtohet. Kjo përfshin pjesët më të ndjeshme të Bosnjë-Hercegovinës dhe në veri të Kosovës dhe mendoj se këtu aktorët relevantë shtetërorë kanë ndërmarrë qëndrime të forta se nuk mbështesin përdorimin e forcës në këto zona. Por, ne na duhet ta largojmë diskutimin përdorim mjetet që kemi në një mënyrë që ne mendojmë se do të ishte produktive", tha O'Brien.

# Kosova me shumë ‘politikanë’ e pa asnjë burrështetas aktual



Shkruan: Safet GËRXHALIJU

Që nga pandemia Covid-19 dhe lufta në mes të Rusisë dhe Ukrainës bota ka përjetuar ndryshime të shumta por edhe me sfida të papritura dhe të rrezikshme. Gjeopolitika po ndryshon duke u krijuar tabore dhe aleanca politike, ekonomike, kulturore dhe historike. Pjesa më e madhe e botës është në proces të zgjedhjeve politike duke filluar nga ShBA, BE, Britania e Madhe, India por edhe në shumë shtete tjera. Ndërkaq fryma

majtiste, nacionaliste por edhe separatiste është në rritje e sipër. Këtë e dëshmojnë rezultatet e zgjedhjeve qoftë në Francë, BE, Slllovakia, Britani, etj. Ballkan Perëndimor vazhdon të prodhojë edhe më tutje më shumë histori dhe të kaluar se sa normalizim politik, ekonomik, kulturor, social, integrues dhe perspektive evropiane.

Emëruesi i përbashkët i zgjidhjes së problemeve në Ballkanin Perëndimor është arritura e një marrëveshje përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë, por që të dyja palë janë shumë afër por edhe shumë larg. Nga prolongimi i dialogut maratonik në mes të Kosovës dhe Serbisë koston më të madhe në këtë drejtim po e paguan Kosova. Dominimi i agjendës politike po i lë jashtë fokusit shumë procese strategjike në interes të shtetit dhe

perspektives evropiane të Kosovës. Në kohën e kremitimit të 25-vjetorit të çlirimit të Kosovës të jemi nën masa ndëshkuese apo sanksione nga Bashkimi Evropian besoj se është mjerimi më i madh që e ka katandisur Kosovën. Aroganca e pushtetit përballë qytetarëve, përballë sektorit privat, përballë sindikatave dhe zbatimi i formulës famëkeqe se ‘në qoftë se nuk je me ne, je kundër nesh’ është rrezik në rritje. Tentativa për barazi në varfëri dhe jo në zhvillim ekonomik dhe qëndrueshmëri vazhdon të dominojë në Kosovë. Bizneset shumë më tepër dënohen sesa që mbështeten apo rieduktohen e trajtohen. Raportet e acaruar me shtetet mike evropiane, në veçanti Shtetet e Bashkuara të Amerikës që janë meritorët më të mëdhenj përlirinë dhe Pavarësinë e Republikës së

Kosovës është ushqimi më i mirë për armiqë tonë shekullor.

“Njeriu që fle në gjumë e ke lehtë përt a zgjuar por atë që aktron se po fle e ke të pamundur përt a zgjuar”. Në Republikën e Kosovës kritika është armiqësi dhe jo nënë e të mësuarit, prandaj servilizmi i ndërtuar në pa dijeni por në militantizëm partiako-politik është vlera e pushtetit aktual.

Kosovë i duhen liderë që gjejnë zgjidhje të problemeve dhe prolongim apo bajpasim të problemeve.

Në Kosovë mjerisht ka shumë “politikanë” por asnjë burrështetas që ka guxim të ngritet mbi interesa për pushtet dhe përt a ushqyer militantët partiaq. Duhet të kemi lider, i cili jep kontribut në të mirë të shtetit dhe qytetarëve të tij, i cili do të forcojë dhe vazhdon partneritetin me shtetet mike evropiane dhe ShBA-të. Duhet të

jemi falënderues ndaj tyre dhe bashkërisht me ta siç e fituam lirinë, duhet ta forcojmë ardhmërinë, sepse ketë e meriton Republika Kosovës, sakrifica përliri. Këtë e meritojnë qytetarët e Kosovës dhe perspektiva euroatlantike.

Gaboni të gjithë ju “politikanë” dhe armiq në qoftë se mendoni se Republika e Kosovës është e përkohshme, është e arritura më e madhe në historinë e kombit tonë dhe një realitet i pranuar nga shumica e botës demokratike, prandaj pranojeni këtë realitet dhe vepronit përshtetin e Republikës së Kosovës, sepse në fund Republika jonë do të jetojë për shumë mote mu për inati të “politikanëve” dhe armiqve të saj - e në të mirë të popullit tonë, miqve dhe partnerëve strategjikë që ishin me ne në këtë rrugëtin sa strategjikë po aq edhe historik.

## Sërisht zjarr në objektin e Institutit të Mjekësisë Ligjore



**PRISHTINË, 30 QERSHOR** - Instituti i Mjekësisë Ligjore bëri me dije se në orët e hershme të 30 qershorit, një nga korridoret e daljes emergjente të tij është përfshirë nga zjarri. Në njoftimin e IML-së u tha se zjarri u lokalizua nga stafi dhe më pas u shua nga zjarrfikësit. “Sipas vlerësimeve preliminare, shkaku i zjarrit ka qenë defekti elektrik në

njëren nga pajisjet elektrike në korridor, mirëpo mendimi përfundimtar do të jepet pas ekspertizës finale e cila do t'i dorëzohet Prokurorisë. Dëmi material është i vogël”, u tha në njoftim.

Vitin e kaluar në IML kishin shpërthyer dy zjarre, në mars dhe në nentor.

Në njoftimin e 30 qershorit, IML-ja tha se ndërtesa e institutit do t'i nënshtrohet rinosimit, sapo të përfundojnë procedurat e prokurimit, në fillim të muajit korrik.

Projekti për renovim, në vlerë prej 900 000 eurosh, sipas IML-së, do të përfshijë “instalimin e sistemit mjekoligjor në vend përt a siguruar shërbime mjekoligjore, mësimdhënie dhe shërbime

riparimin e instalimit elektrik, ventilimin dhe klimatizimin e ri, si dhe ridizajnimin e hapësirave të punës”.

Instituti i Mjekësisë Ligjore është përgjegjës përt menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemit mjekoligjor në vend përt a siguruar shërbime mjekoligjore, mësimdhënie dhe shërbime

përkrahëse përt familjet e personave të zhdukur. Po ashtu, IML-ja ka përt detyrë sigurimin e ekspertizës mjekoligjore përt organet publike, udhëheqjen e hetimeve mjekësore përt vdekjen në vendin e ngjarjes, kryerjen e zhvarrosjeve, kryerjen e inspektimeve pas vdekjes dhe kryerjen e autoprsive.

## “Histori e kulturë”, Osman viziton Muzeun Etnologjik

**PRISHTINË, 30 QERSHOR** - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osman, së bashku me bashkëshortin, Prindon Sadriu dhe dy vajzat, ka vizituar Muzeun Etnologjik në Prishtinë në këto ditë të nxeha vere, duke shprehur interesimin e saj për

historinë dhe kulturën e vendit. Gjatë vizitës Osman eksploroi ekspositat e muzeut, duke vlerësuar pasurinë e objekteve të cilat reflektojnë trashëgiminë kulturore të Kosovës. “Nga vizita në Muzeun Etnologjik në Prishtinë - histori e kulturë, por

edhe freski në këto ditë të nxeha vere”, ka shkruar Osman në “Facebook”.

Muzeu Etnologjik në Prishtinë mbetet një ndër institucionet kulturore të rëndësishme, që ruan historinë dhe traditat e Kosovës.



# Inspektimi i ushqimit, mbi 400 mijë kilogramë produkte u asgjësuan nga AUV-i gjatë këtij viti

**PRISHTINË, 30 QERSHOR** - Mbi 400 mijë kilogramë produkte janë asgjësuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë gjatë këtij viti, produkte këto të cilat nuk i kishin plotësuar kushtet për konsum. Kështu ka treguar për Telegrafen, zëdhënësi i AUV-it, Lamir Thaçi. "Edhe këtë vit kemi pasur produkte që janë larguar në disa raste. Arsyja ka qenë ruajtja joadekuante. Sasia e përgjithshme e asgjësimit për këtë vit e kalon rreth 400 mijë kilogramë. Nuk është vetëm për shkak të kushteve të ruajtjes, por me lajmërimin e vet bizneseve për arsyet e ndryshme, mungesë dokumentacioni dhe origjine, të cilat kanë rezultuar me analiza që nuk janë për konsumim", ka thënë Thaçi.

Thaçi u ka bërë thirrje qytetarëve të kenë kujdes në produktet ushqimore, sidomos në këto



temperatura të larta. Ai ka dekluar se të gjithë produktet që janë në treg janë të inspektaura dhe janë të sigurta për konsumim. "Në secilin

inspektim gjithmonë e shkruan gjendjen faktike në terren. Kushdo që vendos produkte të dyshimta edhe në kodin penal edhe me ligje të tjera përcaktohet

që të ketë ndjekje penale ndaj tij apo të shqiptohet gjobë mandatore. Kjo është, sipas vlerësimit të inspektorit në terren, në rastin kur është

vlerësuar se në terren është vendosur një produkt në treg që është i dyshimtë, ai e inicion fletëparaqitjen në gjykatë. Pastaj gjykata është ajo që e peshon fajin dhe ndëshkimin", shtoi Thaçi.

Kujtojmë se muaj më parë, pas pretendimeve të ngritura për sigurinë dhe cilësinë e mishit të eksportuar në Shqipëri nga një subjekt ekonomik vendor, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në Kosovë ka dalë me një sërë sqarimesh rreth rastit. Inspektimet e kryera nga AUV nuk kishin gjetur asnjë parregullsi që do të kishte ndikim në sigurinë ushqimore. "Mishi i freskët i eksportuar është prodhim i therjeve të kafshëve në Kosovë dhe i është nënshtuar kontrollit veterinar në të gjitha fazat e procesimit", kishte njoftuar AUV.

## Kosova me shkallë të lartë të varfërisë, Sadiku: Rritja ekonomike, e pamjaftueshme

**PRISHTINË, 30 QERSHOR** - Varfëria, mungesa e fuqizimit të sektorit prodhues, mospërkrashja e bizneseve, ngadalësimi i rritjes ekonomike në vend, janë disa nga problemet që po ballafaqohet Kosova 25 vjet pas çlirimt.

Profesor universitar Muhamet Sadiku, derisa kërkon nga qeveria më shumë reforma në çështjet që ndikojnë në ekonominë, thotë se Kosova vazhdon për vite të tëra të përballet me probleme të njëjtë. Në një intervistë për KosovaPress, profesori Sadiku thotë se derisa të gjitha vendet kanë bërë indeksimin e shpenzimeve sociale e të pensioneve, Qeveria e Kosovës nuk ka lëvizur në këtë aspekt, përfshirë thotë se kjo ka ndikuar që të mos zhvillohet ekonomia e vendit. Sipas Sadikut, në vend mungon ndjesia për zhvillim social e që, sipas tij, Kosova vazhdon t'i ketë problemet e njëjtë edhe në shëndetësi, arsim dhe në sektorë të tjera.



"Në përgjegjësi statistikat, vlerësimet e eksperteve, tregojnë se Kosova gjendet në një situatë tejet të vështirë, sepse së pari

përballet me disa probleme bazike afatgjatë, të cilat nuk janë zgjidhur për këto mbi 20 vjet. Kosova gjithnjë përballet

me probleme të reja të cilat i sjell zhvillimi, sidomos kjo ka ardhur në shprehje gjatë paraqitjes së krizës së madhe

para tri viteve kur Kosova, edhe pse është në Eurozonë, është ballafaquar me inflacion të lartë dhe ky inflacion ka paraqitur goditje të madhe për popullatën, sidomos për atë të varfër, popullatën që jeton në asistencë teknike dhe përpensionistët", ka thënë ai.

Derisa flet për ngecjet ekonomike, Sadiku rendit problemet që po ballafaqohet vendi në aspektin ekonomik, dhe shton se sfidë mbetet bilanci tregtar negativ. Në këtë drejtim vlerëson se Kosova duhet ta fuqizojë sektorin eksportues. "Është e papranueshme që Kosova pas 24 vjetëve të çlirimt, profesorët universitarë dalin me 100 euro pension dhe si mund të flitet për një qeverisje moderne të Kosovës. Kjo nuk duhet të lë askënd të qetë. Ndërsa problemet e mëdha është bilanci tregtar negativ. Vazhdimisht në këto 20 vjet e kemi rritjen e importit disa herë më të madhe se eksporti", ka dekluar Sadiku.

## Dorëzohet raporti vjetor i BQK-së për vitin 2023

**PRISHTINË, 30 QERSHOR** - Guvernatori i BQK-së, Ahmet Ismaili, ia ka dorëzuar kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, raportin vjetor të BQK-së për vitin 2023 në pajtim me nenin 28 dhe 59 të Ligjit për BQK-në.

Guvernatori Ismaili e njoftoi kryetarin Konjufca me përmbytjen e Raportit Vjetor 2023 që pasqyrat punët dhe operacionet e BQK-së, performancën dhe stabilitetin e sektorit financiar dhe ekonomisë së vendit. Raporti përmban pasqyrat financiare të

audituara dhe të miratuar nga Bordi i BQK-së. "Raporti paraqet qëndrueshmërinë afatgjatë financiare të BQK-së dhe realizimin me sukses të objektivave dhe detyrate të ngarkuara nga Kushtetuta dhe Ligji për BQK-në. Vlen të theksohet se ky është viti i parë pas Pavarësisë së Kosovës që BQK-ja si institucion kushtetues ka arritur ta plotësojë normën e përcaktuar ligjore në Llogarinë e Rezervave të Përgjithshme (neni 56 i Ligjit), duke siguruar qëndrueshmërinë financiare. Madje, sipas kërkësave ligjore

(neni 56 i Ligjit), BQK-ja ka arritur të alokojë 50 % të të ardhurave të ndashme si të hyra për Buxhetin e Republikës së Kosovës", thuhet në njoftim.

Më tej, në njoftim thuhet se BQK, si institucion i pavarur kushtetues dhe i besueshëm që punon në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme ndaj publikut, me profesionalizëm dhe gjithëpërfshirje mbetet e përkushtuar për arritjen e objektivave dhe realizimin e planit strategjik të saj si dhe në komunikimin institucional në pajtim me mandatin kushtetues.



# Kryediplomatja e ardhshme e BE-së



Krerët e BE vodosën të enjten në samitin e Brukselit për emrat e rind drejtues në BE. Pasuese Josep Borrell pritet të jetë kryeministrja estoneze, Kaja Kallas. 47 vjeçarja, Kaja Kallas e njeh mirë politikën europiane. Gati në finish, pasi emrat e rind që do duhet të drejojnë BE duhet të miratohen edhe nga Parlamenti European. 27 crerët e BE vodosën të enjten me shumicë të emërojnë, Ursula von der Leyen për presidentë të Komisionit European. Italia abstenoi, pas kishte pakënaqësi për emërimet. Antonio Costa emërua si drejtues i Këshillit të BE. Kurse kryeministrja estoneze, Kaja Kallas pritet të jetë e ngarkuara e re BE për politikën e Jashtme duke zëvendësuar kështru të ngarkuarin aktual, Josep Borrell. Kërët e BE vodosën të enjten për kandidaturën e saj në samitin e Brukselit.

Megjithata Kallas ka ende disa pengesa që duhet të kalojë derisa të emërohet përfundimisht si kryediplomatja e BE. Kallas vetë është shprehur, se nëse flitet për postin e të ngarkuarës së politikës së Jashtme, bëhet fjalë vetëm për një kandidaturë. Në një intervistë për radion publike estoneze, Kallas tha se, të enjten (fjala është për samitin e BE ku përcaktohen emrat e posteve të rëndësishme në BE, shën.red.) nuk është ende e vendosur, se kush do të jetë i ngarkuari i ardhshëm i BE për politikën e Jashtme. Bëhet fjalë vetëm kush do të jetë kandidat." Por ky është "nder i madh përmua dhe Estoninë." Planet e Kallas ishin të bëhej Sekretare e Përgjithshme e NATO-s, por për disa në NATO ajo konsiderohet politikane me një gjuhë të ashpër. Në konfliktin e Lindjes së Mesme, megjithatë,

ajo mban një linjë më të ekuilibruar se Borrell, i cili konsiderohet i afërt me palestinezët.

## Familje me traditë politike

47 vjeçarja, Kaja Kallas e njeh mirë politikën europiane dhe është një politikane shumë e kërkuar në samitet e BE. Që nga fillimi i luftës në Ukrainë, Kallas ka kërkuar që Ukraina të ndihmohet shpejt dhe me eficiencë. Kallas mban një qëndrim të hapur kundër presidentit rus, Putin dhe është në listën e personave të kërkuar nga Rusia. "Ai do që të kemi frikë, po me këtë ne do t'i jepnim atij atë që do të arrijë. Prandaj nuk duhet të kemi frikë", është shprehur Kallas në një intervistë për radion estoneze. Kallas konsiderohet në Estoni si

"zonja e hekurt", megjithëse ka pak të përbashkëta me ish-kryeministren britanike, Margaret Thatcher. Ajo vjen nga një familje me traditë politike. Në vitin 1991, pas pavarësimit të Estonisë nga Rusia, babai i saj, Siim Kallas u bë ministër i Jashtëm dhe Financash. Ishte Siim Kallas që negocioi anëtarësimin e Estonisë në BE dhe NATO, si kryeministër estonez në vitet 2002-2003. Siim Kallas ka qenë edhe komisioner i BE për valutën e çështje ekonomike.

Kallas para politikës ka bërë karrierë si avokate. Me angazhimin në politikë, Kallas u bë eurodeputete dhe më pas kryeministrja e parë estoneze, vendin që ka një kufi direkt me Rusinë, ku jeton një minoritet i madh rus. Maja Kallas me qëndrimin e saj miqësor por të vendosur, ka bërë që Estonia të ketë peshë në BE.

## Popullariteti i Kallas në rënienë në Estoni

Media gjermane, "tagesschau" analizon kalimin e Kallas nga politika kombëtare në atë të BE, duke u shprehur se ky hap mund të ketë edhe arsyë të brendshme politike. Popullariteti politik i Kallas ka vuajtur shumë pas masave të forta të kursimit të marra nga qeveria e saj. Në zgjedhjet evropiane, partia e e reformave e Kallas u rendit e treta me rreth 17,9%. BE-ja nuk ka vërtet një ministër të Jashtëm, sepse diplomacia konsiderohet si një detyrë kryesish kombëtare. Në vend të kësaj, për rreth 15 vjet, BE ka një "Përfaqësues të Lartë për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë", që drejton Shërbimin Evropian të Punëve të Jashtme (EEAS) me rreth 4,500 punonjës dhe është gjithashtu pjesë e Komisionit të BE-së.

# Nadya Tolokonnikova dhe kisha e saj kundër Putinit

Nga: Valeriya SAFRONOVA /  
The Financial Times

Në vitin 2012, aktivistja ruse Nadya Tolokonnikova u dënuar me dy vjet burg për "huliganizëm të motivuar nga urrejtja fetare", kjo pasi grupi i saj Pussy Riot protestoi kundër regjimit të Vladimir Putinit në një shfaqje brenda Katedrales së Krishtit Shpëtimtar në Moskë. Ajo tashmë e ka ndërtuar kishën e vet. Brenda mureve industriale të OK Linz-it, muzeut të artit bashkëkohor në Austrinë veriore, versioni i kishës së Tolokonnikovas mbështet revolucionin dhe nuk i shmanget seksualitetit femëror. Ngjyrat janë e kuqja dhe e zeza, ndërsa lidere janë gratë e veshura me të brendshme dhe maska.



Qelia e izolimit



Kukullat e seksit



Shpata e Demokleut, instalacion nga Nadya Tolokonnikova



Thjesht, T'rbim

Ekspozita e parë personale e Tolokonnikovas titullohet thjesht T'rbimi [Rage]. Në veprat e vjetra dhe të reja, reflekton luftën e saj për të balancuar frikën e zemërimin me trimërinë dhe shpresën, duke përdorur motive nga Kisha Ortodokse Lindore, duke përfshirë ikonografinë dhe muzikën. Duket se pyesin: a mund ta kundërshtosh dhunën me mirësi? A mund të ekzistojë besimi pa fe? Dhe, a mundet dikush që jeton në mërgim të mbajë një pjesë të vatanit?

"Besimi ka vend shumë të rendësishëm në jetën time, por jo si pjesë e ndonjë feje të organizuar", thotë Tolokonnikova, 34 vjeçë, ndërsa kalojmë nëpër ekspositë. "Duhet të besoj në disa ideale më të larta, që më ndihmojnë t'i

tejkaloj momentet e tmerrshme të cilat vazhdimisht i sjell jeta si aktiviste".

Që nga lirim i saj nga burgu në vitin 2013, Tolokonnikova – e cila për arsy sigurie nuk tregon se ku aktualisht ndodhet – ka qenë e zënë. Aktiviteti i saj rezultoi në emërtimin e saj si "agjente e huaj" në Rusi, në vitin 2021, akuzë që përdoret për të shtypur opozitën dhe që cilësohet si nder mes aktivistëve anti-Putin. Vitin e kaluar emri i saj u gjet në listën e personave të kërkuar nga Ministria e Brendshme ruse.

Në vitin 2022 e krijoj "Hirin e Putinit", një video-performancë në të cilën ajo dhe 11 gra të tjera të veshura me fustane të shkurta të zeza dhe me geta, djegin portretin e Putinit në një shkretëtirë të paspecifikuar, ndërsa mbledhin hirin në shishe të vogla qelqi. Vepra u shfaq në Galerinë Jeffrey Deitch në Los Anxhelos, në fillim të vitit 2023, dhe më vonë u ble nga Muzeu i Artit në Bruklin. Versioni i veprës tanë është eksposuar në OK Linz në një dhomë të errët dhe të frikshme.

Në murin përballë varen katër piktura akrilike, ose "Ikona" siç i ka quajtur Tolokonnikova, që përshkruajnë anëtaret anomime të Pussy Riot – me aureolë të formuar nga poezië ose citatet. Njëra nga fytyrat rrëthohet nga citimi i një eseje të autorit disident të epokës sovjetike, Alexander Solzhenitsyn. Gjatë kohës së saj në burg,

muzikore të Pussy Riot, përfshirë atë gjatë Lojëra Olimpike Dimërore të Soçit më 2014. Gjatë asaj kohe, thotë Tolokonnikova, ajo jetoi në frikë të vazhdueshme. "Njerëzit thjesht kalonin pranë dhe na goditnin me grusht ose na hidhnin antiseptik në fytyrë", thotë ajo. "Kam pasur sulme paniku në metro."

Kjo frikë është e dukshme në një veprë tjetër, "Shpata e Demokleut". "Çdo qeveri shtypëse autoritare është thikë me dy tehe", thotë Tolokonnikova. "Ka rezik për ne aktivistët ... por, ka edhe rezik për diktatorin. Putini e ka rrethuar veten me armiq dhe për çdo krijon më shumë armiq". Përkthim(i pjesshëm): Telegrafi.com



Këto sakrifica janë evidente në pjesën e dytë të ekspositës, të vendosur lart. Aty Tolokonnikova ka riprodhuar qelinë e saj të vjetër. E njëjta dhomë përmban kujtime nga koha e saj prapa grilave. Krahë shënimive, letrave dhe deklaratës që shkroi kur organizoi një grevë urie, janë fotot e vajzës së saj Gera e cila mbushi katër vjet në vitin 2012.

Një gazetë me fytyrën e Putinit në faqen e parë dhe një artikull i shkurtër për arrestimin, shtrihen pranë një vizatimi të bërrë nga vajza e saj. Vizitorët mund të shohin anën tjetër të dhomës, përmes shufrale të çelikut. Aty ekranet shfaqin video të projekteve dhe protestave



Portreti i Alexei Navalnyt në eksposít.



Kapella e t'rbimit me pamje nga Hiri i Putinit

**Euro Glass**  
 Saint-Gobain Sekurit  
 Pilkington Enveri  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com

**sport**  
 EURO 2024  
 GERMANY



## Ekipet me më së shumti tifozë në 'Euro 2024', Shqipëria lë pas kombëtare të mëdha

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Mbi 95 mijë tifozë shqiptarë kanë qenë pjesëmarrës në shkallët e stadiumeve për ta përkrahur Shqipërinë në "Euro 2024", duke lënë pas vetes shumë kombëtare të mëdha dhe duke u tejkualuar vetëm nga Kroacia, Gjermania dhe Turqia. Mediet gjermane kanë publikuar një listë të shteteve me më së shumti tifozë të pranishëm në Kampionatin Evropian që po mbahet në Gjermani.

Turqia kryeson listën, edhe ndjekur nga nikoqiri Gjermania, ndërsa në vendin e tretë janë të pozicionuar kroatët.

Të dhënat e zyrës së sigurisë së UEFA-s kanë rënë në duart e mediave gjermane dhe sipas këtyre të dhënavë mbi 95 mijë tifozë shqiptarë kanë "pushtuar"



stadiumet gjermane gjatë tri ndeshjeve të fazës së grupeve. Nikoqiri Gjermania ka pasur 125

mijë tifozë të pranishëm, teksha Turqia kryeson listën me 130 mijë sosh.

Kjo tregon më së miri mobilizimin fantastik që patën bashkëkombësit tanë që jetojnë në diasporë por edhe nga tretat tjera të cilët nuk u kursyen aspak ndaj përkrahjes së kombëtares kuqezi.

Shqipëria ka lënë prapa vetes kombëtare të mëdha si Holanda, Anglia, Italia, Belgjika, Franca, Italia, Spanja e shumë të tjera.

**Lista e plotë e kombëtareve me më së shumti tifozë të pranishëm në "Euro 2024":**

Turqia: 130 mijë tifozë  
 Gjermania: 125 mijë tifozë  
 Kroacia: 103 mijë tifozë

Shqipëria: 95 mijë tifozë  
 Rumania: 92 mijë tifozë  
 Skocia: 82 mijë tifozë  
 Holanda: 80 mijë tifozë  
 Serbia: 73 mijë tifozë  
 Polonia: 70 mijë tifozë  
 Anglia: 65 mijë tifozë  
 Austria: 60 mijë tifozë  
 Danimarka: 60 mijë tifozë  
 Gjeorgjia: 60 mijë tifozë  
 Ukraina: 53 mijë tifozë  
 Belgjika: 50 mijë tifozë  
 Hungaria: 46 mijë tifozë  
 Sllovenia: 44 mijë tifozë  
 Franca: 41 mijë tifozë  
 Zvicra: 39 mijë tifozë  
 Republika Çeke: 38 mijë tifozë  
 Portugalia: 37 mijë tifozë  
 Italia: 36 mijë tifozë  
 Sllovakia: 35 mijë tifozë  
 Spanja: 34 mijë tifozë.

## Spanja dhe Anglia kalojnë në çerekfinale të 'Euro 2024'

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Spanja ka kaluar në çerekfinale të "Euro 2024". "Stuhia e Kuqe" ka triumfuar bindshëm 4:1 ndaj Gjeorgjisë në 1/8 e finales në Kampionatin Evropian. Megjithatë, fillimi nuk ishte i lehtë për ekipin e Luis de la Fuentes.

Le Normand ka shënuar autogol, duke e kaluar Gjeorgjinë në epërsi në minutën e 18-të të ndeshjes. Rodri me një goditje të saktë nga distanca ka barazuar shifrat në minutën e 39-të të ndeshjes. Pjesa e dytë ishte e gjitha për spanjollët. Fabian Ruiz ka përmbytur gjithçka dhe ka kaluar Spanjën në epërsi në

minutën e 51-të. Nico Williams me një super depërtim shënoi për 3:1 në minutën e 75-të të ndeshjes. E Dani Olmo realizoi në të 83-tën për 4:1 dhe epilogun e këtij takimi. Në çerekfinale, Spanja do të përballet me Gjermaninë, e cila e ka eliminuar Danimarkën.

Në çerekfinale ka kaluar edhe Anglia. "Tre Luanët" kanë triumfuar pas vazhdimeve 2:1 ndaj Sllovakisë në një ndeshje tepër vështirë për ta.

Ivan Schranz, fillimisht ka kaluar Sllovakinë në epërsi në minutën e 25-të të takimit. Më pas, dominimi ishte i terti i Anglisë, por që nuk ka

arritur ta thyenin mbrojtjen sllovake, të udhëhequr nga Milan Skrinari. Megjithatë, goli i barazimit ka ardhur në minutën e pestë shtesë. Ishte Jude Bellingham që ka shënuar gol akrobatik për ta barazuar ndeshjen. E me të nisur vazhdimet, Anglia ka shënuar edhe golin e epërsisë që në fund doli edhe gol i fitores dhe kualifikimit. Në çerekfinale, Anglia do të përballet me Zvicerën, e cila ka eliminuar Italinë. Sot (e hënë) në orën 18:00 ballafaqohen Franca dhe Belgjika, ndërsa në orën 21:00 Portugalia dhe Sllovenia.



## Gazeta italiane për Granit Xhakën: Nuk i la lojtarët tanë ta prekin topin



PRISHTINË, 30 QERSHOR - Zvicra e ka imposhtur me rezultat 2:0 Italinë, duke prekur fazën çerekfinale të "Euro 2024". Freuler dhe Vargas ishin dy autorët e golave për "helvetikët". E gazeta e njohur italiane, "Tuttomercatoweb", i ka kushtuar vëmendje edhe lojës së kapitenit të Kombëtares zvicerane, Granit



## Deputetët e Kosovës tregojnë forcën ndaj atyre të Shqipërisë, fitojnë 5:0

Prishtinë, 30 qershor - Deputetët e Kosovës bashkë me deputetët e Shqipërisë kanë luajtur në një ndeshje futbolli të dielën në stadiumin e Hajvalisë. Rezultati ishte i thelli i

deputetëve të Kosovës, ku imposhtën homologët e Shqipërisë me rezultat 5:0. Kjo ndeshje është zhvilluar në shënim të 25-vjetorit të çlirimtë Kosovës.

Xhaka, i cili në vazhdimesi pati paraqitje të mira deri më tanë duke arritur që dy herë gjatë fazës së grupeve të shpallet "Futbollist i ndeshjes".

Për Xhakën, kjo gazetë ka shkruar se "nuk i kishte lënë futbollistët italianë që ta prekin topin".

Ai së bashku me Remo Freulerin, e kanë dominuar komplet ndeshjen. "Freuler dhe Xhaka dominuan ndeshjen e djeshme ndaj Italisë, në një ndeshje që asnjëherë nuk ishte realist në diskutim. Freuler, përvèç golit të hapjes, e certifikoi paraqitjen me një ecuri të vazhdueshme, së bashku me Xhakën që nuk i la lojtarët tanë të prekin topin. Formë e shkëlqyer fizike dhe tanë në çerekfinale zviceranët duan të vazhdojnë kështu", shkruan kjo gazetë.



## SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

<b>Titulli i vendit të punës:</b>	Zyrtar/e për mbikëqyrje të sistemeve të pagesave
<b>Grada e pozitës:</b>	gjashtë (6)
<b>Kohëzgjatja e punësimit:</b>	me afat të pacaktuar
<b>Departamenti:</b>	i Infrastrukturës së Tregut dhe Pagesave
<b>Mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë:</b>	Udhëheqësi/ja i/e Divizionit për Mbikëqyrje dhe Analiza të Sistemeve të Pagesave

### Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësive:

- Vlerëson, analizon dhe mbikëqyrë sistemin e pagesave si tërësi, instrumentet individuale dhe mënyrat e reja të pagesave elektronike të përdorura në kuadër të sistemit të pagesave në vend;
- Kontribuon në hartimin e politikave, rregullave dhe procedurave/manualeve përmibikëqyrjen e sistemit të pagesave, në pajtim me standartet ndërkombëtare, me fokus parimet e BIS/CPSS përrregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave;
- Realizon vlerësimin e sistemit të pagesave në pajtim me rregullat e mbikëqyrjes dhe kryen monitorimin e pajtueshmërisë me legjislatinon dhe rregullativën në fuqi që të siguroj që sistemet e pagesave funksionojnë në mënyrë të sigurt, të qëndrueshme dhe efektive;
- Vlerëson sistemin e pagesave dhe përgatit analiza të rreziqueve, përfshirë rrezikun e likuiditetit, rrezikun operacional, rrezikun kreditor, rrezikun ligjor dhe rrezikun sistemik të sistemit të pagesave;
- Siguron që sistemet e pagesave garantonin shkallë të lartë sigurie dhe besueshmërie operacionale, si dhe që sistemet e pagesave të kenë procedura përvazdimësinë e punës në raste të jashtëzakonshme;
- Kontribuon, në bashkëpunim me departamentin e licencimit, në vlerësimin e kërkesave të reja për regjistrimin dhe licencimin e institucioneve dhe operatorëve të pagesave, të kliringut dhe shlyerjes së letrave me vlerë, si dhe shërbimeve tjera të pagesave;
- Kontribuon në rishikimin dhe plotësimin e strategjisë përvazdimësinë e sistemit kombëtar të pagesave;
- Kontribuon në përgatitjen dhe plotësimin e kërkesave/standardeve të parapara në kuadër të kërkesave për proceset integruese në BE të ndërlidhura me fushë e pagesave;
- Realizon vlerësimin e infrastrukturës teknike dhe ligjore të pjesëmarrësve të ri në sistem;
- Kontribuon në projektet hulumtuese që ndikojnë në zvogëlimin e parasë së gatshme në qarkullimin dhe iniciimin dhe promovimin e pagesave elektronike;
- Udhëheqë dë angazhohet në inspektimet e ofruesve të shërbimin e pagesave, si dhe operatorëve tjerë të mundshëm të sistemeve të pagesave;
- Komunikon dhe koordinohet me Departamentet dhe Divizionet tjera të BQK-së lidhur me kërkesat dhe nevojat që rrjetin, përmbarëvajtjen e mbikëqyrjes të operatoreve të pagesave individualist dhe të sistemit në tërësi;
- Në pajtim me standartet e BE-së, analizon mundësitë e përshtatjeve të reja në infrastrukturë teknike dhe ligjore përfunksionim më efikas të sistemit të pagesave dhe rekomanon lidhur me mundësitë përngritjen e cilësisë së shërbimeve të pagesave;
- Ndihmon Udhëheqësin e Divizionit/Drejtoret në komunikimin dhe takimet me palët e jashqitje (ofruesit e shërbimeve të pagesave, operatorët) dhe palët e brendshme (departamentet/divizionet) përshtatjeve përfshira në kuadër të fushëve të përgatit;
- Sipas nevoje, realizon punë të tjera të lidhura me mbikëqyrjen e sistemeve dhe instrumenteve të pagesave në kuadër DSP-së, të deleguara nga mbikëqyrësi apo hierarkia më lartë apo me obligimet që rrjetin, përmbarëvajtjen e mbikëqyrjes të operatoreve të pagesave individualist dhe të sistemit në tërësi;

### Përgatitjet Profesionale/Kualifikimet:

- Diplomë universitare në fushën e shkencave të ekonomisë, shkencave juridike, shkencave matematiko-natyrore, apo relevante;
- Përvjohet prej së paku tre (2) viteve të ndërlidhur me kornizën ligjore (vendore dhe ndërkombëtare) direktivat, standartet, infrastrukturën dhe shërbimet e pagesave në BE por edhe më gjera.
- Shkathësi në nxjerrjen e të dhënavë statistikore dhe analizave në funksion të mbikëqyrjes së sistemeve dhe shërbimeve të pagesave;
- Shkathësi të shkëlqyeshme organizative, planifikimi dhe të menaxhimit të kohës;
- Shkathësi të shkëlqyeshme ndër-personale dhe të komunikimit, si dhe aftësi në zgjidhjen e konfliktit;
- Saktësi, vëmendje në detaje, si dhe ndjeshmëri ndaj prioriteteve;
- Njohuri të shkëlqyeshme të përdorimit të aplikacioneve softuerike të pakos MS Office;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar;
- Njohja e gjuhës angleze përparsësi.

### Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi përkëtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvjohen e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetëtimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvjohen e punës, pa cenuar aktet relevante përmbytjen e të dhënavë personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** përiudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërmjofitimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

### Procedura e aplikimit:

- Afat i fundit për aplikim është **15 korrik 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)



## OBJAVA SLOBODNOG RADNOG MESTA

<b>Naziv radnog mesta</b>	Službenik za nadzor platnih sistema
<b>Stepen pozicije:</b>	Šest (6)
<b>Trajanje radnog odnosa:</b>	Na neodređeno vreme
<b>Odeljenje:</b>	Tržišne i platne infrastrukture
<b>Direktori supervisor:</b>	Rukovodilac Odseka za nadzor i analizu platnih sistema

### Opis dužnosti i odgovornosti:

- Ocenjuje, analizira i nadzire platni sistem u celini, pojedinačne instrumente i nove metode elektronskog plaçanja koje se koriste u platnom prometu u zemlji;
- Doprinosi izradi politika, pravila i procedura/priručnika za nadzor platnog sistema, u skladu sa međunarodnim standardima, sa fokusom na BIS/CPSS principe za regulisanje i nadzor platnih sistema;
- Vrši procenu platnog sistema u skladu sa pravilima nadzora i vrši praćenje usklađenosti sa zakonodavstvom i propisima na snazi kako bi se obezbedilo da platni sistemi funkcionišu na bezbedan, stabilan i efikasan način;
- Procenjuje platni sistem i priprema analize rizika, uključujući rizik likvidnosti, operativni rizik, kreditni rizik, pravni rizik i sistemski rizik platnog sistema;
- Osigurava da platni sistemi garantuju visok stepen sigurnosti i operativne pouzdanosti, kao i da platni sistemi imaju procedure za kontinuitet rada u izuzetnim slučajevima;
- Doprinosi, u saradnji sa odeljenjem za licenciranje, proceni novih zahteva za registraciju i licenciranje platnih institucija i operatera, kliring i saldiranje hartija od vrednosti, kao i druge platne usluge;
- Doprinosi pregledu i dopuni strategije razvoja nacionalnog platnog sistema;
- Doprinosi pripremi i ispunjavanju zahteva/standarda predviđenih u okviru zahteva za integracione procese u EU koji se odnose na oblast plaçanja;
- Vrši procenu tehničke i pravne infrastrukture novih učesnika u sistemu;
- Doprinosi istraživačkim projektima koji utiču na smanjenje gotovine u opticaju i pokretanje i promociju elektronskog plaçanja;
- Vodi i angažuje se u inspekcijsima pružalaca platnih usluga, kao i drugih potencijalnih operatera platnih sistema;
- Komunicira i koordinira sa drugim odeljenjima i odsecima CBK-a u vezi sa zahtevima i potrebama koje nastaju, za nesmetano funkcionisanje nadzora platnih operatera pojedinačno i u celini;
- U skladu sa standardima EU-a analizira mogućnosti novih adaptacija u tehničkoj i pravnoj infrastrukturni za efikasnije funkcionisanje platnog sistema i daje preporuke u vezi sa mogućnostima za podizanje kvaliteti platnih usluga;
- Pomaže Rukovodiocu/direktoru odseka u komunikaciji i sastancima sa spoljnim stranama (pružaćima platnih usluga, operaterima) i internim stranama (odeljenja/odseka) o pitanjima koja su obuhvaćena delokrugom;
- Po potrebi obavlja i druge poslove u vezi sa nadzorom platnih sistema i instrumenata u okviru OPS-a, koje delegira supervisor ili viši hijerarhijski ili sa obavezama koje proizilaze iz opštih radnih obaveza.

### Profesionalne pripreme/kvalifikacije:

- Univerzitetska diploma u oblasti ekonomskih nauka, pravnih nauka, matematičko-prirodnih nauka, ili relevantni;
- Iskustvo od najmanje tri (2) godine u vezi sa pravnim okvirom (domaćim i međunarodnim), direktivama, standardima, infrastrukturom i platnim uslugama u EU i šire.
- Veština vađenja statističkih podataka i analiza u funkciji nadzora platnih sistema i usluga;
- Odlične organizacione veštine, veštine planiranja i upravljanja vremenom;
- Odlične međuljudske i komunikacijske veštine, kao i veštine rešavanja konflikata;
- Tačnost, pažnja na detalje i osetljivost na prioritete;
- Odlično poznavanje korišćenja softverskih aplikacija MS Office paketa;
- Tečno poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika u govoru i pisaju;
- Prednost znanja engleskog jezika.

### Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK za apliciranje;
- Propratno pismo (motivaciono pismo) u kojem se naglašava interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje funkcije i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata o zaštiti podataka o ličnosti);
- Izveštaj Kosovskog penzionog štednog fonda (Trusta)** za relevantni period, ili potvrda Poreske uprave (ATK) kada izveštaj Fonda nije zakonski primenjen;
- Kopije diplome, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/ nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

### Postupak apliciranja:

- Rok za apliciranje je **15 Jul 2024**.
- Aplikacija se može izvršiti onlajn (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične web stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostali oblici za apliciranje neće se razmatrati.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti preko zvanične web stranice: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregatitje për intervistë



[facebook](#)


[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumé's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatr-it, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

## LAJMEROJMË

Bashkëpronarët Akil Shabani, Xulka Shabani, Ferit Shabani dhe Feriz Shabani, nga Fshat Lubizhdë, Komuna Prizrenit, si Blerësit potencialse, me Bashkëpronarët Marko Nikoliq, Angjela Nikoliq dhe Zorica Nikoliq, si bashkëpronarë ligjor të ngastrave kadastrale me numër P-71813046-0161-7, sipërfaqe të përgjithshme prej 2994 m<sup>2</sup>, në Zonën Kadastrale Lubizhdë, po i Shesim - pjesët tona bashkëpronësore.

Në këtë mënyrë i ofroj bashkëpronarëve, poqë se janë të interesuar për blerje, të më lajmërohen

në afat prej 30 ditëve, në adresë: rr. "Saracve" nr.49/A – Prizren.

Një herri informoj se e kam Blerësin potencial i cili brenda afatit prej 30 ditëve do ta paguan çmimin e përgjithshëm prej 6.500 €/ar me para të gatshme-në kesh.

Telefoni kontaktues: +383-44-351-471

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Kastriot Sedolli shpall te pavlefshme diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.
- Katarina Lekaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "At Shtjefen Gjecovi" Zym.
- Ernst Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V shfmu "Abdyl Frasher" Prizren.
- Vahide Sertilli shpall te pavlefshme dëftesat Q.K "11 Marsi" Prizren.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", katër tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesë me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesë një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fludi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kočola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales





TRADITË QË NGA  
1992

